



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.83, datë 27.07.2020

**“PËR
MIRATIMIN E PROJEKTMARRËVESHJES SË BASHKIMIT TË SHOQËRISË
“REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 SH.A, TIRANË ME SHOQËRINË
“NDËRMARRJA E TRAJTIMIT TË STUDENTËVE NR. 3” SH.A, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 3, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “d”, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, Vendimit nr. 45, datë 29.04.2020, të Këshillit Bashkiak “Për nisjen e procedurave të bashkimit me përthithje të shoqërisë “Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve nr. 3” sh. a nga shoqëria përthithëse “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1”, sh.a Tiranë”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1”, sh.a, Tiranë dhe shoqërisë “Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve nr. 3”, sh.a, Tiranë,

V E N D O S I :

1. Miratimin e projekt marrëveshjes së bashkimit të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1”, sh.a Tiranë, si shoqëri përthithëse dhe shoqërisë “Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve nr. 3” sh.a, Tiranë, si shoqëri e përthithur, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që marrin pjesë në bashkim të ndjekin procedurat përkatëse të regjistrimit të marrëveshjes së bashkimit dhe prishjen e shoqërisë që përthithet pa kaluar në procesin e likuidimit, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
3. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Shoqëria “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1”, sh.a, Tiranë dhe Shoqëria “Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve nr. 3” sh.a, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.






BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK



Nr. 30419 / prot.
1

Tiranë, më 14, 9, 2020

Lënda: Dërgim vendimesh

REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1 SH.A

NDËRMARRJA E TRAJTIMIT TË STUDENTËVE NR.3 SH.A

Bashkëlidhur, Ju dërgojmë vendimin e miratuar nga Këshillit Bashkiak Tiranë realizuar në mënyrë elektronike datë **27 Korrik 2020**, si më poshtë:

1. **Vendimi nr.83, datë 27.07.2020** “Për miratimiun e projekt marrëveshjes së bashkimit të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 sh.a, Tiranë” me shoqërinë “Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve nr.3 sh.a Tiranë”.

SEKRETAR

Behar Zeneli

